VENDIM
Nr.469, datë 16.6.2010

PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË KONCESIONIT APO TË VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA", DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË KONCESIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24/1 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e "Rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Në pikën 1 të kreut XII të tekstit që i bashkëlidhet vendimit nr.27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave, emërtimi "... APP ..." zëvendësohet me "... Komisioni i Prokurimit Publik ...".
3. Ngarkohet Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË KONCESIONIT APO TË VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura, nga Komisioni i Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të ndryshuar.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:
a) "Komisioni" është Komisioni i Prokurimit Publik.

b) “Ligji nr.9663/2006” është ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar.

c) “Rregullorja e Komisionit të Prokurimit Publik” nënkupton rregulloren e miratuar me vendimin nr.184, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”” dhe për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike”.

Neni 3
Parimet e veprimtarisë

1. Gjatë ushtrimit të funksionit të shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura, Komisioni respekton parimet e:

a) ligjshmërisë;

b) barazisë dhe mosdiskriminimit;

c) pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;

ç) shqyrtimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme; dhe

d) transparencës dhe informimit të publikut;

dh) mbrojtjes së të dhënave personale, sekretit shtetëror ose tregtar.

2. Në veprimtarinë e tij, Komisioni zbaton kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe kujdeset për efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

Neni 4
Organizimi dhe veprimtaria e Komisionit

Komisioni organizohet, funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me kreun II të rregullores së Komisionit të Prokurimit Publik.

KREU II
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Neni 5
E drejta e ankimit

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikimin administrativ, nëse çmon se një veprim i ndërmarrë nga autoriteti kontraktues ose Agjencia e Prokurimit Publik është në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi për procedurat e koncesionit, ndaj:

a) procedurave të koncesionit;

b) vendimit për përjashtimin nga këto procedura.

2. Ankesa i paraqitet Komisionit brenda 5 ditëve kalendarike, në rrugë elektronike, përveçse kur sipas legjislacionit në fuqi parashikohet një mjet tjetër komunikimi. Ky afat, në varësi të shkakut të ankesës, fillon:

a) nga data e marrjes dijeni të vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik për përjashtimin nga procedurat e koncesionit;

b) nga data e botimit të vendimit të parakualifikimit, sipas nenit 15 të ligjit nr.9663/2006; ose

c) nga data e botimit të njoftimit të renditjes së ofertuesve nga autoriteti kontraktues.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e ankesës

1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr.1, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht:

a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit (emri dhe adresa e ankuesit);

b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi;

c) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

e) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar;

f) Dokumentin bankar që vërteton kryerjen e pagesës paraprake sipas përcaktimeve ligjore.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) Provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) Kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) Kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

Neni 7
Regjistrimi i ankesës

1. Ankesat paraqiten në mënyrë elektronike dhe regjistrohen menjëherë. Komisioni mban një regjistër të posaçëm elektronik për regjistrimin e ankesave, i cili publikohet në faqen zyrtare, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Komisioni nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e ankesave.

3. Përmbajtja e regjistrit të ankesave, formati i standardizuar i tij, si dhe rregullat e mbajtjes dhe administrimit të regjistrit, janë të njëjta me ato të regjistrit të ankesave të prokurimeve publike, të përcaktuara në rregulloren e Komisionit të Prokurimit Publik.

Neni 8
Rregulla të përgjithshme procedurale

Rregullat për caktimin e çështjes dhe njohjen me aktet, përjashtimin e kryetarit, anëtarëve, inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur, në kushtet kur gjenden në një nga rastet e konfliktit të interesit, si dhe pjesëmarrja dhe detyra e inspektorëve në shqyrtimin e një ankimi sipas ligjit nr.9663/2006, janë të njëjta me ato të përcaktuara në rregulloren e Prokurimit Publik.

Neni 9
Verifikimi paraprak

1. Me caktimin e çështjes, relatori verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës dhe i relaton fillimisht Komisionit rezultatet e verifikimit lidhur me:

a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b) legjitimimin e ankuesit;

c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d) elementet e domosdoshme të ankesës së parashikuar në nenin 7 pika 2 të kësaj rregulloreje;

e) pagimin ose jo të pagesës paraprake prej 10% të vlerës së garancisë së ofertës.

2. Komisioni shqyrton paraprakisht dhe merr vendim brenda 7 ditëve edhe për pezullimin ose jo të procedurave të koncesionit, si dhe për fillimin e procedurave të hetimit administrativ. Lidhur me këto çështje relatori paraqet mendim me shkrim pranë Komisionit.

3. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës, Komisioni verifikon nëse kërkesa është e argumentuar juridikisht, nëse pezullimi është ose jo në kundërshtim me interesin publik, si dhe nëse pezullimi dëmton në mënyrë joproporcionale autoritetin kontraktues ose ofertuesit e tjerë.

4. Komisioni, gjatë shqyrtimit paraprak, merr një nga vendimet e mëposhtme:

a) Mospranimin e ankesës për shkak të mungesës së kushteve formale të saj, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në këtë rast, Komisioni ia njofton vendimin ankimuesit brenda 3 ditëve, duke i treguar edhe të drejtën për t'u ankuar në gjykatë;

b) Fillimin e procedurës së hetimit administrativ dhe kalimin e ankesës për shqyrtim të thelluar. Në këtë rast, me kërkesë të relatorit, bazuar në aktet e bashkëlidhura ankesës, Komisioni vendos edhe nëse duhet marrë vendimi i specialistëve/ekspertëve të pavarur, si dhe njofton ankuesin për afatin e parapagimit të ekspertëve. Njoftimi përmban edhe paralajmërimin se në rast të mosparapagimit të ekspertizës në afatin e caktuar, Komisioni nuk thërret dhe nuk merr si provë ekspertizën e kërkuar;

c) Pezullimin e procedurave të koncesionit, duke specifikuar arsyet e këtij pezullimi;

d) Vazhdimin e procedurave të koncesionit, në rast se ndodhemi në një nga kushtet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, duke specifikuar edhe arsyet e mospezullimit.

5. Komisioni vendos mospezullimin e procedurës koncesionare nëse vlerëson se:

a) ankesa nuk është e argumentuar juridikisht;

b) pezullimi është në kundërshtim me interesin publik; ose

c) pezullimi dëmton autoritetin kontraktues ose ofertuesit e tjerë.

6. Brenda 7 ditëve kalendarike nga momenti i marrjes së vendimit, Komisioni njofton autoritetin kontraktues për pezullimin ose jo të procedurave të koncesionit, si dhe për fillimin e procedurave të hetimit administrativ.

Neni 10

Shqyrtimi në themel

1. Nëse Komisioni merr vendim sipas paragrafit "b" të pikës 4 të nenit 10, ai vazhdon me shqyrtimin në themel të kërkesës brenda së njëjtës mbledhje. Nëse vazhdimi nuk është i mundur sepse nevojitet marrja e një prove të caktuar apo kryerja e hetimeve më të thelluara, mbledhja e radhës zhvillohet brenda 7 ditëve kalendarike. Në çdo rast Komisioni duhet të përfundojë hetimin administrativ, të marrë vendimin, si dhe të njoftojë autoritetin kontraktues dhe ankuesin për vendimin, brenda 30 ditëve nga regjistrimi i ankesës.

2. Relatori i çështjes, pasi shqyrton në mënyrë të hollësishme ankesën dhe dokumentacionin shoqërues të saj, përgatit një informacion të detajuar mbi rastin dhe ia paraqet Komisionit.

3. Komisioni ka të drejtë të kërkojë të dhëna dhe shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, të marrë çdo dokument apo provë që ka lidhje me hetimin administrativ, si dhe t'i caktojë afat autoritetit kontraktues apo institucioneve të tjera, për vënien në dispozicion të informacionit apo dokumentacionit të kërkuar.

4. Komisioni vendos mbi një ankesë në mbledhje me dyer të mbyllura.

5. Gjatë mbledhjeve mbahet procesverbal, i cili përmban arsyet e votimit pro ose kundër, si dhe rezultatin përfundimtar të votimit. Procesverbali nënshkruhet nga personi që e mban atë dhe nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje. Çdo anëtar mund të kërkojë të njihet me përmbajtjen e procesverbalit, të marrë një kopje të procesverbalit, si dhe ka të drejtë të paraqesë objeksionet e tij mbi përmbajtjen e procesverbalit.

Neni 11

Veprime të tjera gjatë shqyrtimit në themel

Nëse Komisioni vlerëson se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin nr.9663/2006, dhe kontrata koncesionare ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë dhe të korrigjojë shkeljen sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së koncesionit;

b) Të shfuqizojë pjesërisht apo plotësisht vendimet ose aktet e autoritetit kontraktues.

Neni 12
Kufijtë e shqyrtimit të ankesës

1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së koncesionit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.

Neni 13
Vendimi i komisionit

1. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të ankesës dhe pasi të gjithë anëtarët kanë shprehur mendimin e tyre mbi çështjen, kryetari i Komisionit deklaron mbylljen e shqyrtimit administrativ të ankesës dhe fton anëtarët që të votojnë.

2. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni merr një nga vendimet e mëposhtme:

a) pranon ankimin e ankuesit, duke argumentuar shkeljen e konstatuar në zbatimin e ligjit e të procedurave për koncesionet, duke treguar masat përkatëse për anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë në veprimet e autoritetit kontraktues;

b) rrëzon ankimin e ankuesit, duke argumentuar zbatimin e drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.

3. Në rast se Komisioni, në përfundim të procesit të hetimit administrativ, konstaton shkelje të procedurave të koncesionit e mosrespektim të parimit të ligjshmërisë, përveç vendimit të parashikuar në paragrafin “a” të pikës 2 të këtij neni, i jep autoritetit kontraktor një afat, brenda të cilit ky i fundit është i detyruar t’i ndreqë ato ose të ndalojë efektin, apo pasojat negative të këtyre shkeljeve.

4. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankim, sipas rregullave për ankimimin e akteve administrative.

Neni 14
Përmbajtja e vendimit

1. Vendimi i Komisionit përmban numrin, datën, nënshkrimin, vulën e Komisionit, si dhe në mënyrë të shprehur rregullat për ushtrimin e së drejtës së ankimit në gjykatë.

2. Vendimi i Komisionit duhet të arsyetohet dhe të përmbajë të gjitha elementet që duhet të ketë një akt administrativ, në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Të gjitha kopjet e vendimit nënshkruhen nga kryetari.

4. Vendimi i njoftohet ankimuesit dhe autoritetit kontraktor.

Neni 15
Shpenzimet procedurale

1. Shpenzimet procedurale përfshijnë tarifën e ankesës dhe shpenzimet për konsultimin e

specialistëve/ekspertëve të pavarur.

2. Kur Komisioni, në procedurën e shqyrtimit të një ankese, urdhëron thirrjen e specialistëve ose të ekspertëve, sipas listës vjetore të parashikuar në nenin 8 të rregullores së Komisionit të Prokurimit Publik dhe kryerjen e ekspertizës, duhet të përcaktojë detyrimin e palëve për parapagimin e tyre dhe afatin.

3. Parapagimi i shpenzimeve vërtetohet duke paraqitur dokumentacionin bankar përkatës.

4. Palët në proces mbulojnë shpenzimet e ekspertizës.

5. Komisioni përcakton në vendimin që përfundon procedimin administrativ edhe detyrimin se kujt i ngarkohen shpenzimet procedurale. Për ankesën pjesërisht të suksesshme, shpenzimet procedurale përcaktohen në përputhje me masën e pjesës së ankesës së pranuar.

Neni 16
Karakteri detyrues i vendimeve të Komisionit

1. Vendimi i Komisionit ka karakter detyrues për autoritetin kontraktor.

2. Vendimi i Komisionit është i ekzekutueshëm dhe ankimimi i tij në rrugë gjyqësore nuk pezullon vazhdimin e procedurave të koncesionit.

KREU II
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Arkivimi i dokumentacionit

Arkivimi i dokumentacionit të krijuar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura, i nënshtrohet të njëjta rregullave, të përcaktuara në rregulloren e prokurimit publik.

Neni 18
Dispozitë tranzitore

1. Komisioni vazhdon shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në gjendjen në të cilën ato ndodhen. Afati për shqyrtimin e tyre fillon nga data e dorëzimit nga Agjencia e Prokurimit Publik te Komisioni i Prokurimit Publik.

2. Komisioni vazhdon shqyrtimin e ankesave ndaj procedurave të ankandit, të paraqitura pranë tij, përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, për aq sa është e mundur me rregullat e vendosura në këtë rregullore.

Aneksi nr.1

FORMULARI I ANKESËS DREJTUAR KOMISIONIT

Ankesë drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik
Seksioni I: Identifikimi i ankimuesit
Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose i mundshëm

_____

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

_____

Adresa

_____ _____ _____

Qyteti Shteti Kodi postar/Kodi Zip

_____ _____

Nr.telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) Nr.faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

_____

E-mail

_____

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem shtypeni)

_____ _____

Firma e zyrtarit të autorizuar Data (viti/muaji/dita)

_____ _____

Nr.telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) Nr.faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për procedurën

1. Numër identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet standarde të procedurës konkurruese, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për koncesionet kundër të cilit bëhet ankimi (p.sh., procedurë me parakualifikim (me dy faza), procedurë pa parakualifikim).

_____

2. Autoriteti kontraktues

Emri i autoritetit kontraktues që administron procesin e konkurrimit.

_____

3. Vlera e përllogaritur e procedurës konkurruese

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë).

_____

4. Objekti i kontratës

Përshkrim i shkurtës i objektit të kontratës "dhënien me koncesion".

_____

_____

5. Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

_____

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e përcaktimit të kontratës fituese

_____

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore e ankesës
(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente etj.).

_____

2. Deklaratë e hollësishme e fakteve dhe argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumenteve standarde të procedurës konkurruese, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

_____
____

Seksioni IV. Kundërshtimi paraprak ndaj autoritetit kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar ndaj një vendimi të autoritetit kontraktues. Bashkëngjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë, edhe përgjigjen, nëse ka një të tillë.

1. Shkallët e ndjekura të ankimit:
Keni bërë ndonjë ankim për këtë procedurë konkurruese, nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (p.sh., me shkrim, nëpërmjet faksit), organin shtetëror dhe llojin e vendimit të dhënë (duke përshkruar edhe nëse organi nuk është shprehur fare për ankimin tuaj).

Po	Jo

Nëse PO të jepen detajet dhe dokumentacioni përkatës

_____
__

2. Dokumentacioni bankar që vërteton pagesën e tarifës së ankimit.

3. Pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar.
Çfarë vendimi kërkoni të marrë komisioni?

_____
_____

4. Lista e shtojcave
a) Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkëngjisni një kopje të lexueshme të të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjitha këtyre dokumenteve. Dokumentet duhet të përfshijnë ***normalisht çdo njoftim të publikuar,***

të gjitha dokumentet standarde të procedurës konkurruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën; dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.

b) Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumenteve përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

c) Përcaktoni nëse kërkoni përjashtimin e ndonjërit prej anëtarëve të Komisionit për konflikt interesi.

d) Përcaktoni nëse kërkoni ekspertizë të posaçme për shqyrtimin e ankimit.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për koncesionet, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: Komisionit të Prokurimit Publik.

KUJDES: Një kopje e kësaj ankese duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit kontraktues dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nr.fax: e-mail:

Nënshkrimi dhe vula e ankuesit